

Ramazani, mundësi për edukim dhe arsimim

[Albanian – Shqip – الباني]



Muhamed Salih El-Munexhid



Përktheu: Almedin Ejupi

Redaktor gjuhësor: Jeton Koçinaj

Redaktor fetar: Jusuf Kastrati

رمضان فرصة للتربية والتعليم



محمد صالح المنجد



الترجمة: ألمدين أيوبي

المراجعة الشرعية: يوسف كاستراتي

**Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**



Falënderimi i takon vetëm Allahut. Dëshmoj se nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka shok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Ndër tiparet e një njeriu të mençur është të jepet pas mirësive e dhuratave të ndryshme të Allahut dhënë robërve të Tij në vende dhe kohë të vlefshme. Ndër këto mirësi janë edhe ato të muajit Ramazan, muajit të Kuranit dhe faljes.

Ky muaj fisnik është sezon për edukimin e shpirtit për nënshtrim ndaj Allahut, edukim për t'u larguar nga të këqijat si dhe për të mësuar normat e fesë së pastër. Ky muaj është një mundësi jashtëzakonisht e madhe për thirrësit që t'i edukojnë dhe t'ua mësojnë njerëzve çështjet e fesë së tyre. Mu për këtë,

thirrësit mezi i presin këto mundësi për ta çuar në vend urdhrin e Allahut, për të punuar e për t'i thirrur njerëzit në të vërtetën.

1. Muaji Ramazan është mundësi për edukimin sipas metodologjisë së drejtë në marrjen e dijes dhe fetuave (vendimeve fetare). Nxënësi i dijes e shfrytëzon këtë muaj për t'ua mësuar njerëzve dispozitat e fesë, për të vendosur metodologjinë e shëndoshë në pranimin e atyre dispozitave. Sa për ilustrim, mund të përmendim: kujdesin ndaj argumentit si dhe argumenti të jetë i saktë. Gjithashtu, të pyeturit e dijetarëve të besueshëm rreth normave që nuk i di, mosndjekja e shkarjeve (gabimeve) të dijetarëve dhe lehtësimeve të tyre. Sa të nevojshëm janë njerëzit për t'i njohur këto çështje metodologjike, te të cilat fillimisht

mbështetet personi kur kapet e praktikon çështjet e fesë së tij.

2. Muaji Ramazan është mundësi për edukimin e njerëzve për t'iu nënshtruar urdhrit dhe gjykimit të Allahut, si dhe kur vjen çështja te tekstet fetare, nuk ka diskutim e as kundërshti në mes tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre.”** (Nisa, 65) Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, iu afrua Gurit të Zi, e puthi dhe tha: “Vërtet, unë e di se ti je vetëm një gur, që nuk sjell as dëm e as dobi. Sikur të mos e shihja të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi*

ue selem, duke të të puthur, nuk do të të puthja.”¹

3. Ibn Haxheri, në librin e tij *Fet’hul Bari*, thotë: “Në këtë thënie të Omerit ka argument për nënshtrim në çështjet e fesë dhe pasim i asaj që nuk i njihet urtësia. Ky është një rregull madhor në pasimin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në veprimet e tij, edhe nëse nuk i njihet urtësia.”² Ndaj, njerëzit patjetër duhet të mësojnë nga muaji Ramazan, t’ua mësojnë të tjerëve respektimin e teksteve fetare, moskundërshtimin e tyre, si dhe mosdhënien përparësi logjikës kundrejt tekstit, siç veprojnë injorantët në këtë kohë.

¹ *Mutefekun alejh*, motërzimi është i Buhariut. Buhariu, 1520 dhe Muslimi, 1270.

² *Fet’hul Bari sherh Sahih el Buhari*, 3/463.

4. Medoemos duhet shfrytëzuar mundësinë e këtij muaji fisnik për ta edukuar shpirtin me sinqeritet. Agjërimi është një adhurim i fshehtë, që nuk vihet re sikurse adhurimet dhe bindjet e tjera. E, nuk ka dyshim se marrja në konsideratë e këtij kuptimi ndihmon në rritjen dhe në përmirësimin e sinqeritetit në shpirt. Prandaj, ky lloj agjërimi mund të jetë mundësi për forcimin e vetëpërmbytjes dhe shtysës së brendshme, që është këshilluesi i Allahut në zemrën e çdo muslimani. Agjërimi vjen për t'ia kujtuar njeriut rëndësinë e këtij këshilluesi, si dhe për ta forcuar e zhvilluar atë.
5. Gjithashtu, agjërimi është mundësi e volitshme për edukimin dhe forcimin e vullnetit. Njeriu e mposht armikun e tij, e thyen egon, e përballon etjen dhe

urinë, e, në këtë ka zbehje të dëshirës për braktisjen e gjërave të rëndomta.

6. Po ashtu, ndër gjërat e rëndësishme që përfitojmë në Ramazan është edhe të mësuarit e njerëzve çështjen se feja është e lehtë. Ky aspekt është jashtëzakonisht i rëndësishëm, për faktin se në shumicën e mendjeve njerëzore është ngulitur bindja se në fe ka vështirësi, rreptësi e ashpërsi. Kjo është pikëpamje që e propagandojnë armiqtë e fesë nëpër artikujt dhe në shkrimet e tyre tek pretendojnë kinse në fe paska shtypje, pranga e kufizime. Prandaj, patjetër duhet të shfrytëzohet mundësia e Ramazanit, dispozitat dhe lehtësimet e tij të ndryshme. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u dërgua me fenë tolerante e të lehtësuar, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Ai (Allahu) nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj.”**

(Haxh, 78), respektivisht nuk ju ka ngarkuar me atë që nuk mund ta bartni e as nuk ju ka obliguar me diçka që ju rëndon e të mos ju caktojë rrugëzgjdhje dhe lehtësim të madh. Ai ka urdhëruar e ka obliguar vetëm atë që është e lehtë për shpirtrat, që nuk i rëndon e nuk i neverit. E, nëse paraqiten shkaqet obliguese për lehtësim, atëherë vjen në shprehje lehtësimi: ja me lënien e tërësishme, ja me lënien e pjesshme të tij. Lidhur me dispozitat e agjërimit, që tregojnë lehtësinë e fesë, ekzistojnë shumë shembuj të sjellë nga dijetarët, andaj duhet përfituar nga rasti për t'i mësuar njerëzit se kjo fe është e lehtë. Mirëpo, njëkohësisht nuk lejohet abuzimi me dispozitat e fesë. Te disa njerëz çështja e lehtësimit arrin deri në atë shkallë sa të dalë jashtë kuptimeve dhe kufijve të fesë, saqë bën hile me dispozitat

fetare, gjë që konsiderohet formë e talljes, mënyrë dhe rrugë e benu israilëve, të cilët, me hilet e mashtrimet më të ulëta, lejuan atë që ka ndaluar Allahu. Feja, ashtu siç e lufton keqpërdorimin, e lufton edhe ekstremizmin dhe teprimin. Si shembuj të kësaj mund të përmendim: nuk lejohet agjërimi i ditës së Bajramit, ndalohet vazhdimësia e agjëritit pa ndërprerje, pa bërë iftar fare sepse kjo konsiderohet teprim.

7. Ramazani është mundësi e favorshme për t'ua mësuar njerëzve madhësitinë e kësaj feje. Ndër madhësititë e kësaj feje është ajo se përfshin të gjitha çështjet bashkëkohore, sikurse çështja e: dializës, anesteziës, mjeteve penguese të menstruacioneve, mbushjes së nervit të dhëmbit, pastës së dhëmbëve, udhëtimit me aeroplan, injeksioneve, transfuzionit të gjakut,

astmës, ushqyeseve, e të ngjashme. Për të gjitha këto ke për të gjetur përgjigje në fe, me tekst apo analogji, e di ai që e di e s'e di ai që s'e di. Kjo e argumenton gjerësinë e kësaj feje dhe madhësinë e saj, si dhe kjo fe është e përshtatshme për çdo kohë e vend. Ndër aspektet më të rëndësishme që përfitojmë nga muaji Ramazan është dallimi ynë nga të tjerët me besimin dhe fenë tonë. Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush.”** (Bekare, 183) Ithtarët e Librit ndryshuan, falsifikuan dhe devijuan atë që ua kishte urdhëruar Allahu. Agjërimi, fillimisht, të krishterëve iu obligua në stinën e verës. Kjo i rëndoi, ndaj e qitën në pranverë, duke ia shtuar edhe dhjetë ditë, siç pretendonin ata, si shpagim për ndryshimin. Më pas, ata i

goditi krizë ekonomike me çështjen e mishit, djathit, vezëve dhe prodhimeve të kafshëve. Një prej mbretërve të tyre urdhëroi që të agjërohet ndaj këtyre produkteve, ndaj ky dekret u bë agjërim tek ata. Allahu e mbrojti këtë umet nga ndryshimi dhe devijimi në dispozitat e fesë së tyre.

8. Ramazani, me adhurimet e tij të shumanshme, është mundësi ideale për t'i inkurajuar njerëzit drejt gjërave të preferuara dhe për t'ua mësuar dispozitat e adhurimeve, ndër to:
 - Tërheqje e vëmendjes rreth vlerës së namazit të teravisë, vlerën e namazit të natës dhe aspekte të tjera të përkushtimit.
 - Udhëzimi rreth shtimit të këndimit të Kuranit dhe të mësuarit e dispozitave dhe normave të këndimit të tij, ngase Ramazani

është muaji i Kuranit dhe njerëzit i përkushtohen atij.

- Gjithashtu, të folurit rreth dispozitave të zekatit, sepse njerëzit e kanë bërë zakon që zekatin e pasurisë së tyre ta nxjerrin në Ramazan.
- Po ashtu, biseda rreth dispozitave të itikafit, etikës nëpër xhami dhe shoqërimit të mirë.
- Të folurit duke sqaruar dispozitat e umres, për shkak të kujdesit të njerëzve për ta kryer gjatë Ramazanit dhe për shkak të vlerës së saj sepse një umre në Ramazan vlerësohet me një haxhillëk. Prandaj, t'i nxisim njerëzit ta kryejnë umren dhe t'ua sqarojmë rregullat e nevojshme që u interesojnë.
- Ramazani është kohë e begatë, ndaj është mirë të kaliturit për të

kryer lloje adhurimesh të dobishme për muslimanët, sikurse dhënia iftar agjëruesve. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Ai që ushqen një agjërues, do ta ketë shpërblimin sikur ai, pa u pakësuar aspak shpërblimi i agjëruesit.”*³ Sa bukur do të ishte sikur të shtroheshin sofrat e iftarit për të varfrit dhe të ngratët dhe të uleshin banorët e lagjes duke bërë iftar bashkë me ta.

- Përgatitja e xhamive, pastrimi, parfumimi dhe të bëhen gati për agjërim e namaz nate, si dhe nevojat e tjera, si: ndriçimi, ajrosja e tyre, e të ngjashme. Gjithashtu edhe udhëzime dhe gjallërim

³ Tirmidhiu, 807 dhe Ibn Maxhe, 1746. Albani e saktëson në *Sahih Sunen et Tirmidhi*.

shtesë që i bën imami i xhamisë për njerëzit për t'i inkurajuar për adhurim.

9. Prej aspekteve kundrejt të cilave duhet tërhequr vërejtjen janë:
 - Sqarimi i dëmeve të kalimit të natës në gjëra të padobishme. Shumë njerëz gjatë Ramazanit e kalojnë natën duke shikuar kanale televizive, shëtitje nëpër parqe, parkingje, trotuare e nëpër tregje duke humbur kohën.
 - Paralajmërimi nga rreziku i tepërimit me ushqim. Ai që kujdeset për çështjet e fesë së tij nuk është tejkalues i masës.
 - Gjithashtu, paralajmërimi nga shndërrimi i këtij adhurimi madhështor në traditë sepse disa njerëzve disa adhurime (ibadete) u bëhen tradita (adete) dhe si

rezultat i kësaj dilet nga thelbi i tyre duke mos lënë asnjë ndikim.

10. Po ashtu, fakti me të cilin duhet t'i kujtojmë njerëzit gjatë Ramazanit është se turpi nuk duhet t'i pengojë nga të kuptuarit e fesë. Kështu, has vashëzën e re, që tashmë i është paraqitur cikli menstrual, ndërkohë e pengon turpi dhe ndrojtja, sipas saj, të njoftojë për problemin e vet. Rezultat i kësaj është se nuk e agjëron muajin Ramazan, ndërkohë agjërimi i është bërë detyrë asaj! Apo ndonjë tjetër, që i shfaqet cikli gjatë ditës së Ramazanit dhe, nga turpi, nuk e njofton familjen e saj, porse e vazhdon agjërimin ditëve të ciklit pa i kompensuar ato ditë!
11. Muaji Ramazan, ky muaj fisnik, është mundësi për t'ua tërhequr vërejtjen njerëzve kundrejt disa haditheve të dobëta (daife). Nuk ka dyshim se përhapja e haditheve të dobëta ka

pasoja të shumta negative. Kjo nënkupton përcjellje nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të asaj që nuk është vërtetuar se e ka thënë ai. Ndër këto hadithe mund të përmendim: *“Gjumi i agjëruesit është adhurim.”*⁴ *“Agjëroni, të jeni të shëndoshë.”*⁵ *“Ai që e prish agjërimin e një dite në Ramazan, pa arsye, nuk e arrin shpërblimin, edhe nëse agjëron tërë jetën.”*⁶ *“Agjërimi i muajit Ramazan qëndron pezull ndërmjet qiellit dhe tokës dhe nuk ngrihet vetëmse me dhënien e sadakatul*

⁴ Bejhekiu, *Shuab el iman*, 3652, që është hadith i dobët. Albani e vlerëson si të dobët në *Silsila daife*, 4696.

⁵ Taberaniu, *El Eusat*, 8312, që është i dobët. Albani e vlerëson si të dobët në *Silsila daife*, 253.

⁶ Ibn Ebu Shejbe, *Musanef*, 9784, që është i dobët. Albani e vlerëson si të dobët në *Daifu Tergib ue terhib*, 605.

fitrit.”⁷ Këto hadithe, dhe të ngjashme, që nuk janë autentike, janë përhapur në mesin e njerëzve. Prandaj, duhet tërhequr vërejtjen për pasaktësinë e tyre, si dhe paralajmërimin kundrejt transmetimit të haditheve para vërtetimit të autenticitetit të tyre.

12. Gjithashtu, të mësuarit e njerëzve kujdesin dhe interesimin për Sunetin gjatë rasteve që duhet të shfrytëzohen në Ramazan. Çështja e zbatimit të Sunetit konsiderohet çështje e rëndësishme metodologjike. Sunetet i plotësojnë farzet, e lartësojnë pozitën e njeriut, ndihmojnë drejt devotshmërisë dhe ruajtjes së shpirtit. Ndër shkaqet e dobësimit të ndikimit të Ramazanit në shpirtat e njerëzve

⁷ Ibn Xheuziu, *El Ilal el mutenahijeh*, 824, që është i dobët. Albani e vlerëson si të dobët në *Daifu Tergib ue terhib*, 664.

ndonjëherë është shpërfillja në përgatitjen e tyre për këtë sezon të madh. Në këtë çështje neglizhencën e vëren te disa ligjërues, predikues e nxënës të dijes. Allahu i Lartësuar agjërimin e ka bërë ndihmesë për thirrësit, ngase në këtë muaj prangosen djajtë, përthyhen shpirtrat dhe largohen shumë shpifje e gënjeshtër, arroganca, shkujdesja dhe dalldi, që e pengojnë përgjigjen ndaj thirrësit të Allahut.

13. Fakti që e shton ndikimin e muajit Ramazan në shpirtrat e njerëzve është kujtimi lidhur me vlerat e Ramazanit, ndër të cilat:

- *“Atij që e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar*

(shpërblim prej Allahut), *i falen mëkatet e kaluara.*⁸

- *“Në Xhenet është një portë e quajtur Rejan. Ditën e Gjykimit nga ajo derë do të hyjnë vetëm agjëruesit, askush tjetër.”⁹*
- *“Era e gojës së agjëruesit tek Allahu është më e këndshme sesa aroma e miskut.”¹⁰*
- *“Agjëruesi ka dy raste në të cilat gëzohet: (1) kur bën iftar, i gëzohet iftarit dhe (2) kur e takon Zotin, i gëzohet agjërimit të tij.”¹¹*
- Sqarimi se agjërimi është mjet drejt devotshmërisë. Meqë shpirti abstenon nga e lejuara, duke

⁸ *Mutefekun alejh*: Buhariu, 38 dhe Muslimi, 760.

⁹ *Mutefekun alejh*: Buhariu, 1797 dhe Muslimi, 1152.

¹⁰ *Mutefekun alejh*: Buhariu, 1805 dhe Muslimi, 1151.

¹¹ *Mutefekun alejh*: teksti është i Muslimit. Buhariu, 1805 dhe Muslimi, 1151.

synuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe duke pasur frikë nga dënimi i Tij, atëherë abstenimi nga e ndaluara është edhe më parësore.

- Kujtimi lidhur me dobitë e agjërimin, ndër të cilat janë edhe këto: nëse stomaku i njeriut është i uritur, atëherë përmbahet edhe epshi i tij; kur të agjërojë, e kupton hallin e të varfërve me rastin e urisë së tyre. Kësisoj i mëshiron dhe u ndihmon atyre, ngase lajmi (i dëgjuar) nuk është sikur të shohësh. Në këtë mënyrë përhapet solidariteti dhe altruizmi.
- Të edukuarit e njerëzve fetarisht. Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcjell se i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: ***“Kur ndonjëri prej jush agjëron, të mos flasë fjalë të ulëta***

e të mos bërtasë kot. E, nëse ndokush e fyen ose e shqetëson, le t'i thotë: "Unë agjëroj!"¹²

- Krahas agjërimit, patjetër duhet të ekzistojë edhe përmbajtja nga gënjeshtra, thashethemet, përgojimi e mashtrimi, domethënë nga të gjitha ndalesat, veçanërisht ato që shpeshtohen e përhapen gjatë netëve të Ramazanit, si: ndjekja e kanaleve të shthurura, të dëgjuarit e instrumenteve zbavitëse, muzikore etj.

14. Ajo që e shton nevojën e sqarimit gjatë Ramazanit është edhe tematika e pendimit dhe ekspozimit ndaj mëshirës së Allahut dhe bujarisë së Tij

¹² *Mutefekun alejh*: motërzimi është i Buhariut. Buhariu, 1805 dhe Muslimi, 1151.

në këtë muaj të fisnikërisë, bujarisë dhe zbritjes së mëshirës. Robi i kthehet Zotit të tij, mban mendim të mirë ndaj Tij, do atë që do Ai, urren atë që nuk pëlqen Ai, me shpresë se Zoti do t'ia falë mëkatet atij. I dështuar dhe i humbur është ai që e arrin muajin e Ramazanit e nuk i janë falur mëkatet!

15. Gjithashtu, Ramazani është mundësi për përcjelljen e këshillës drejtuar femrës, së cilës ndoshta kjo i përcillet vetëm në Ramazan. Përndryshe si mund të ndihet gruaja se është si motër për burrin e saj, se asaj i obligohet t'i mësojë rregullat e fesë, veçanërisht rregullat që janë të veçanta për të, siç janë dispozitat e menstruacioneve dhe lehonisë. Natyrisht, ajo patjetër duhet të kujtohet dhe t'i mësohen rregullat dhe normat fetare që kanë të bëjnë me të

kur të dalë për namaz ose për treg, e të ngjashme, duke iu shmangur parfumimit, të mos shkojë e vetmuar me shoferin apo të veshë rroba stolie. Gjithashtu, asaj i mësohet çështja e moshumbjes së kohës gjatë përgatitjes së ushqimeve, të mos bëjë art me pjata dhe enë, sepse Allahu nuk i do ata që e teprojnë. Po ashtu, të mos preokupohet me përgatitjen e ushqimeve kundrejt adhurimit. Kështu, do të ndiejë ëmbëlsinë e adhurimit, nëse i përkushtohet atij. Llogarit shpërblimin duke u angazhuar me namazin e natës, leximin e Kuranit, dhënien iftar agjëruesve në shtëpinë e saj duke përjetuar shpërblimin: *“Ai që ushqen një agjërues, do ta ketë shpërblimin sikur ai, pa u pakësuar*

aspak shpërblimi i agjëruesit."¹³ Po ashtu, ajo nuk duhet të angazhohet për ta kaluar kohën nëpër tregje duke e humbur kohën më të vlefshme dhe sezonet më të vyera, ngase këto nevoja mund t'i kryejë para ardhjes së këtij muaji.

16. Ramazani është mundësi e mirë për edukimin e fëmijëve tanë në bindje dhe respektim të urdhrave të Allahut duke ushtruar atë që mund të agjërojë. Shokët e të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u bënë fëmijëve të tyre lodra prej leshi, që i përdornin për fëmijën kur ndiente uri dhe dhimbje. Kur qante nga dhimbja e urisë, ua jepnin lodrën derisa të vinte koha e iftarit.

¹³ Tirmidhiu, 807 dhe Ibn Maxhe, 1746. Albani e saktëson në *Sahih Sunen et Tirmidhi*.

17. Gjithashtu, gjatë Ramazanit përgatiten mundësi të shumta për të treguar kujdesin ndaj komuniteteve. Shumë të huaj jetojnë mes nesh. Syresh ka që janë jobesimtarë, të cilët kanë nevojë për ftesë të mirë për të hyrë në fenë e Allahut. Po edhe nga muslimanët ka të atillë që kanë nevojë për mësim dhe udhëzim. Ka të tillë që vijnë nga vendet e tyre me risi të shumta e me bindje të kota. Prandaj, të tillët duhet të kenë hise në përpjekjen e thirrësve. Patjetër duhet të kujdeset për të varfrit e tyre, për mësimin e të paditurve nga mesi i tyre, këshillimin e të shkujdesurve dhe butësinë e dhembshurinë me ta.
18. Roli i thirrësve për tek Allahu i Lartësuar është edhe paralajmërimi lidhur me rreziqet e pashmangshme ndaj umetit që i planifikojnë armiqtë e fesë për t'i larguar njerëzit nga realiteti

i Ramazanit duke i preokupuar ata me programet e kuzhinës dhe gatimit ditor, ku humbet koha, mbrëmjet dhe serialet, programet e organizuara për t'i larguar muslimanët nga feja, për ta devijuar muajin e adhurimit dhe Kuranit në muajin e mëkateve, dëfrimit, argëtimit dhe kalimin e natës në mëkate. Kjo, pa dyshim se është çështje e rrezikshme, me ç'rast thirrësit janë të obliguar t'ua sqarojnë njerëzve këtë gjë.

19. Orientimi i bisedës, i mesazhit dhe përmirësimi i tij për atë që për herë të parë vjen në xhami. Çfarë do t'u themi atyre që i kanë preokupuar zbatimet dhe ndalesat, e që sot janë kthyer të penduar? Thirrës i suksesshëm është ai që ka sukses në fundin e muajit duke arritur fitim të madh. Njerëzit në fillim të muajit ishin të shkujdesur, ndërsa para përfundimit të muajit janë kthyer

të penduar, të rrethuar e të mbuluar me mikun përmes të cilit i udhëzoi Allahu. Kjo është prej kritereve të suksesit të thirrësit tek Allahu.

20. Po ashtu, fakti që duhet të potencohet këtu është edhe dukuria e përtacisë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit. Në ditët e para të Ramazanit vërehet atmosferë gëzimi për adhurim, interesim të shtuar për bindje dhe nënshtrim, pasuar nga një vakje në mesin e muajit. Ndërkaq, kur vijnë dhjetë netët e fundit, me veçoritë dhe vlerat e tyre, zemrat plogështohen, ambiciet dobësohen. Prandaj, kjo periudhë duhet të veçohet që në fillim me tërheqje, joshje dhe nxitje, me qëllim të vazhdimësisë në adhurim.
21. Në fund, duhet t'i tërhiqet vërejtja atij që i thërret të tjerët, porse e harron veten. I tilli patjetër duhet të ketë hise e të përfitojë nga dhuntitë dhe

mëshira e Zotit të tij, nga shkaqet e bujarisë dhe fisnikërisë së Tij, drejt të cilave i fton të tjerët. Prandaj, nuk preokupohet me thirrjen e njerëzve duke harruar vetveten, por duhet të jetë model dhe ndër njerëzit më të kujdesshëm në përkushtimin ndaj adhurimit, në angazhimin me leximin e Kuranit, faljes së namazit, përmendjen e Allahut dhe në të gjitha veprat e mira, që natyrshëm ai i di më mirë se të tjerët.

E lusim Allahun e Lartësuar të na japë sukses në shfrytëzimin e kohëve të vlefshme, që do të na kthehen me dobi për fenë tonë, me qëllim edukimin e shpirtit për në mirësi duke e mësuar atë që i sjell dobi dhe shpëtim. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për të dërguarin tonë Muhamed, për familjen e tij dhe për të gjithë shokët e tij!

